



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Iu f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 mars 2020 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 shkurt 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës mbajtur me 6 mars 2020;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2019;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formim të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij;
6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave (**shqyrtimi i parë**);
7. Shqyrtimi Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
8. Shqyrtimi Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave "Uniteti" për vitin 2019;
10. Shqyrtimi i Projekt-planit të zhvillimit institucional i kujdesit parësor shëndetësor 2020-2024 (**shqyrtimi i dytë**);
11. Shqyrtimi i petitionit i banorëve të lagjeve: "Bregaj", "Haradinaj", "Shala", "Hasani", "Maloku" dhe "Ibrahimi" dhe
12. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për pikat e rendit të ditës me përjashtim të pikës së shtatë (7) dhe tetë (8).

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit